



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e  
Komuniteteve dhe Kthim**

**Legjislatura e III-të**  
**Nr. 02/08**  
**Prishtinë, më 19.03.2008, ora 14:00**  
**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225**

**P R O C E S V E R B A L**

nga mbledhja e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e  
Komuniteteve dhe Kthim

**Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Sanije Aliaj, Müfera Şinik, Kosara Nikolić,  
Sadik Idriz, Numan Balić, Hafize Hajdini, Hetem Arifi, Zylfi Merxha, Mursejl  
Haljilji, Enis Kervan.**

**Anëtarët jo të pranishëm: Bojan Stojanović, Zafir Berisha, Xhevdet Neziraj.**

Gjithashtu të pranishëm ishin: moniturores nga OSCE, KDI, OHCHR.

Nga shërbimi i sekretarisë: Natasha Prica -Tisma, Arta Hajra, Vilson Ukaj.

**Kryesuese: Sanije Aliaj, nënkryetare e parë e komisionit**

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 3. Shqyrtimi i propozim planit të punës së Komisionit për vitin 2008;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/9 për**

- Kooperativat e bujqve, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 6. 2003/25 të datës 6 korrik 2003, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi;**
- 6. Të ndryshme.**

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Kryesuesja hapi mbledhjen dhe propozoi rendin e ditës për këtë mbledhje.

Rendi i ditës u miratua si i tillë i propozuar.

### **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**

Procesverbali nga mbledhja e kaluar dt. 5.03.2008, u miratua pa vërejtje.

### **3. Shqyrtimi i propozim planit të punës së Komisionit për vitin 2008**

**Kryesuesja** prezantoi planin vjetor të punës para anëtarëve të komisionit dhe kërkoi nga ata të japin propozimet e tyre me gojë apo me shkrim më qëllim të plotësimit eventual të tij.

**Enis Kervan** mbështeti planin në parim. Propozoi që në pjesën ku parashihen objektivat e komisionit, konkretisht në pjesën ku rregullohet mbikëqyerja e zbatimit të ligjeve, Komisioni të kushtoj kujdes monitorimit të zbatimit të ligjeve nëpër ato komuna ku jetojnë shumica e komuniteteve në mënyrë që të garantohet përdorimi i gjuhës së tyre. Në këtë drejtim, veçoi tre ligje: Ligji për përdorimin e gjuhëve, Ligji për letërnjoftimet dhe Ligji për dokumentet e udhëtimit që duhet të jetë objektiv e mbikëqyrjes nga ana e Komisionit, për të cilën gjë theksoi se ka marrë mbështetjen e Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

**Numan Balić** propozoi që në pjesën ku rregullohet efikasiteti i punës së Komisionit me institucionet tjera, përveç më institucionet e përmendura të plotësohet edhe bashkëpunimi i Komisionit me Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrinë e Kulturës Rinisë Sportit dhe Çështjeve Jorezidente dhe Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. Në pjesën ku parashihet bashkëpunimi i Komisionit me Institucione vendore të plotësohet bashkëpunimi me policinë e UNMIK-ut dhe me Shërbimin Policor të Kosovës (SHPK-në). Po ashtu në pjesën e bashkëpunimit me institucionet vendore të shtohet bashkëpunimi me Këshillin për Komunitete pranë Zyrës së Presidentit. Ndërsa në pjesën e qëllimeve afatshkurta të Komisionit, ligjet që do të procedohen pas periudhës së tranzicionit të shtohet : garantimi i të drejtave dhe interesave të Komuniteteve.

**Enis Kervan** propozoi që në pjesën e bashkëpunimit të Komisionit me Institucionet vendore të parashihet edhe bashkëpunimi i Komisionit me Zyrën për Komunitete pranë Zyrës së Kryeministrit. Gjithashtu propozoi që në pjesën e qëllimeve të afatgjata Komisionit, në pjesën e parë të shtohet garantimi i tyre me Kushtetutën e R. së Kosovës.

**Kryesuesja** përkrahu propozimet dhe gjithashtu propozoi në pjesën ku trajtohet bashkëpunimi i Komisionit me Institucionet ndërkombëtare të plotësohet edhe bashkëpunimi me USAID-in. Në vend të fjalës HABITAT, të shkruhet Agjencioni Kosovar i Pronave (AKP). Në pjesën e dytë të planit rreth takimeve dhe vizitave brenda dhe jashtë vendit kërkoi të caktohen komunat dhe vendet që duhet të vizitohen në muajt pasues.

**Numan Balić** kërkoi të precizohen vizitat, përgatitjet që duhet bërë Komisioni kur vendos të vizitojë një komunë. Të vizitohen ato komuna ku jetojnë shumica e komuniteteve, psh: Leposaviq, Novobërd, etj.

**Sadik Idriz** duke pasur parasysh faktin se komunat janë në fazën e konstituimit të tyre propozoi që të bëhen nga një vizitë në muaj nëpër komuna. Të vizitohen komunat ku jetojnë shumica e komunitete, si psh: Leposaviq, Novobërd, Fushëkosovë, Dragash, Prizren, etj.

**Kosara Nikolić** u pajtua me mendimi e deputetit S. Idriz dhe propozoi që të vizitohen ato komuna ku jetojnë të gjitha komunitetet në mënyrë që të njoftohemi me problemet e tyre, se sa janë të mbrojtur ata. Nga këto vizita të kërkojmë informacione nga Kuvendet komunale dhe pas hartimit të raportit të i'u drejtohem Ministrisë përkatëse me rekomandimet tona për respektimin e të drejtave të të gjithë komunitetevë që jetojnë në Kosovë.

**Kryesuesja** kërkoi nga anëtarët të propozojnë se cilat vende apo institucione të rajonit dhe të BE-së të vizitohen. Ajo propozoi që në muajt në vazhdim në planin e punës të parshihet vizita e këtyre vendeve të rajonit: Maqedoni, Slloveni, Mal të Zi, ndërsa po ashtu në muajt e ardhshëm të parshihet vizita në institucionet e BE-së.

Pas propozimeve dhe vërejtjeve të dhëna, me votimin e bërë Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

## K O N K L U Z I O N

Miratohet Plani i Punës së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim për vitin 2008 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra.

### **4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/9 për Kooperativat e bujqve, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente**

**Kryesuesja** lexoi raportin e Komisionit funksional me amendamente, lidhur me P/L për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/9 për Kooperativat e Bujqve dhe kërkoi nga anëtarët ta mbështesin atë për arsye se nuk cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve që jetojnë në Kosovë.

Pasi që nuk kishte vërejtje, me votimin e bërë Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

## R E K O M A N D I M

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim përkrahu Projektligjin

për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/9 për Kooperativat e bujqve, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente, me konstatimin se nuk i cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit që në procedurë të mëtejme, ta miratojë atë.

**5. Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 6. 2003/25 të datës 6 korrik 2003, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi**

**Kryesuesja** lexoi raportin e Komisionit funksional, lidhur me P/L për ndryshimin dhe plotësimin e kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe kërkoi nga anëtarët ta mbështesin atë për arsye se nuk cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve që jetojnë në Kosovë.

Pasi që nuk kishte vërejtje, me votimin e bërë Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

**REKOMANDIM**

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim përkrahu Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut, nr.6 2003/25 të datës 6 korrik 2003, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me konstatimin se nuk i cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit që në procedurë të mëtejme, ta miratojë atë.

**6. Të ndryshme**

**Kryesuesja** njoftoi anëtarët për mbledhjen që është mbajtur në mes kryetarëve të komisioneve dhe Kryesisë së Kuvendit dhe ajo e autorizuar ka marrë pjesë në atë mbledhje dhe i ka njoftuar pjesëmarrësit për konstituimin e komisionit dhe përgatitjen e planit të punës. Gjithashtu theksoi se ka kërkuar nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit që ta kenë një përfaqësues në mbledhjet e komisionit për çka edhe ka hasur në mirëkuptim. Po ashtu njoftoi se ka kërkuar edhe nga Ministrinë përkatëse që përmes përfaqësuesve të tyre të marrin pjesë rregullisht në këto mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 15:10

Shërbimi i komisioneve

**Kryesuesja e Komisionit**

\_\_\_\_\_  
**Sanije Aliaj**



